# SHERBIME ADMINISTRATIVE NE FUSHEN E MBROJTJES SE MJEDISIT QE OFRON BASHKIA

1. Kerkese per dhenie mendimi per leje mjedisore tipi: A dhe B.
2. Kerkese per dhenie leje me zgjatje orari te subjekteve te ndryshme te cilat shkaktojne zhurma ne mjedis.
3. Bashkepunon me struktura te tjera institucionale duke dhene informacionet e duhura, ne zbatim te strategjise dhe planit kombetar, per menaxhimin e mjedisit.
4. Adapton politikat kombetare per mbrojtjen e mjedisit ne nivelin e Bashkise Shijak, duke percaktuar objektivat e zhvillimit dhe indikatoret per matjen e tyre ne nivel local.
5. Miraton politika moderne te mjedisit duke u bazuar ne partneritetin me institucione jo qeveritare dhe/ose aktore private ne zhvillime apo probleme te ndryshme te lidhura me mjedisin duke advokuar pjesmarrjen, bashkepunimin dhe standartizimin ne implementimin e planeve zhvillimore.
6. Vlereson, monitoron dhe kontrollon politikat dhe projektet e trajtimit te mbetjeve urbane e rurale, te permiresimit dhe eficences se energjise dhe te promovimit dhe perhapjes se energjive alternative, zonat problematike mjedisore, etj.
7. Bashkepunon ngushtesisht me struktura te tjera institucionale, per zbatimin e projekteve me karakter mjedisor, per zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis, ne bashkepunim me organizma te tjere dhe komunitetin.
8. Bashkepunon me struktura te tjera institucionale duke dhene informacionet e duhura, me qellim permiresimin e metodologjise se trajtimit te mbetjeve ne zbatim te strategjise dhe planit kombetar, per menaxhimin e mbetjeve.
9. Monitoron vendet e depozitimit te mbetjeve nepermjet evidentimit te politikave te hasura dhe raporton tek eprori perkates.
10. Organizon nje regjister te perditesuar te pikave me risk te depozitimit te mbetjeve urbane dhe te ngurta, duke percaktuar dhe kategorine e riskut.

**Legjislacioni ne fushen e mbrojtjes se mjedisit:**

- Ligji 10448"Për lejet e Mjedisit" datë 14.07.2011(ndryshuar me Ligjin 44/2013, date 14.02.2013, nr 60/2014, date 19.06.2014, nr 52/2020, date 30.04.2020),
- Ligji 10440,datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" , i ndryshuar dhe Vendimit Nr.686,datë 29.07.2015 i ndryshuar "Per miratimin e rregullave, të përgjithshme e të afateve për zhvillimin e proçedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis(VNM) dhe proçedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedsisore".
- Ligji 10431 "Për mbrojtjen e Mjedisit" datë 09.06.2011 (ndryshuar me ligjin nr. 31/2013, datë 14.2.2013, nr. 53/2020, datë 30.4.2020).
- Ligji 10463 "Për menaxhimin e integruar te mbetjeve", datë 22.09.2011.

*Si dhe te gjitha aktet nenligjore qe rrjedhin nga keto ligje te lartepermendura.*

| Nr.5 | Projekti: **P7.F1.O2.A3 Hartimi I projekteve teknike prioritare per sistemin e ujitjes , kullimit dhe mbrojtjes nga erozioni.** | Llojet e programit : **P7. Bujqësia dhe Zhvillimi Rural** **Funksioni: P7.F1 Administrimin e infrastrukturës vendore t ujitjes dhe kullimit të tokave si dhe menaxhimin e institucioneve në shërbim të këtij funksioni, sipas mënyrës përcaktuar me ligj;** |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

i. Situata ( Shpjego problemin, aspektet negative, të dhëna për zonën)

Me ndarjen e re territoriale, Bashkia Shijak ka 6752 ha tokë bujqësore në 4 njësitë e saj administrative.
Zhvillimi i këtij sektori strategjik për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm, vazhdon të jetë larg potencialeve reale që ofron territori dhe kjo si rezultat i një : problematikash, të tilla si mungesa e investimeve dhe amortizimi i tejskashëm i sistemit të ujitjes dhe kullimit, ndërtimet e paligjshme në veprat kulluese Degradimi i tokës së punueshme për shkak të përmbytjeve në zona te caktuara (kryesisht në fshatin Sallmone, si dhe gjate gjithe gjatesise se lumut Erz rënia e vegjetacionit, mospërdorimi i tokës për qëllime bujqësore, metodat e papërshtatshme të ujitjes janë disa nga faktorët, të cilat kanë përshpej fenomenin e erozionit në shumë zona, të cilat përdoren për kullote, në kundërshtim me çdo lloj kriteri, duke stimuluar mbipërdorimin e bimësisë dhe për pa rritjen e erozionit dhe dëmtimin e pejsazhit. Problematike paraqitet gjendja përgjatë lumit Erzen,Kanali i Tones dhe kanalet e ujrave te larta ne te gjitha nj Administrative.

Sot Bashkia Shijak , ka në inventarin e saj 90 km kanale ujitëse (ndër të cilat 25.0 km në funksion dhe 65 km jashtë funksionit) dhe 250 km kanale kulluesdyta dhe të treta ( 71 km kanale të dyta dhe 171 km kanale të treta)

Kalimi i funksionit të ujitjes dhe kullimit në Bashki (VKM nr.1108,datë30.12.2015; Ligji nr 147/2015 "Për buxhetin e vitit 2016", Neni 15) dhe krijimi i strukturë Drejtorisë së Bujqësisë, ka sjellë nevojën e studimit të situatës për caktimin e ndërhyrjeve prioritare për të gjitha NJA.

Ky projekt synon hartimin e projekteve teknike në sistemin e ujitjes dhe kullimit, studimeve specifike për mbrojtjen e tokës bujqësore nga erozioni me qëllim futjen e këtij sektori në rrugën bashkëkohore të zhvillimit të bujqësisë

- ii. Synimi i projektit (me një fjali çfarë do të zgjidhni për atë që është problemi kryesor, përfitimi i grupit të synuar)

Përmirësimi i menaxhimit të tokës, përmes hartimit të projekteve teknike prioritare për ndërhyrje dhe mundësia për financim.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit ( Veprimet që do të ndërmerrni për të prodhuar rezultate)

Ngritja e grupit të punës në Bashki ( Drejtoria e Bujqësisë, Sektori i Kullimit dhe Ujitjes dhe Pyjeve, ekspertë të fushës, grupe të interesit)
Mbledhja, përpunimi, kartelizimi dhe njësimi i informacionit të studimeve te kryera;
Vlerësimi i situatës dhe përcaktimi i prioriteteve
Përpilimi i dokumentacionit të nevojshëm për hapjen e procedurave të tenderimit/ prokurimit dhe supervizimit
Lidhja e kontratës me firmën fituese
Fillimi i punës dhe dorëzimi i veprës.

**b) Rezultatet qe prisni ( shërbimet apo produktet që u dorezoni përfituesve të synuar)**

Projekte teknike për riaftësimin e kanaleve kulluese dhe ujitëse të realizuara nuk kemi informacionin e duhur pasi nuk kemi marre projektet teknike nga I kullimit Durres.
Projekte teknike për mbrojtjen e tokës bujqësore nga erozioni të realizuara,mungese e projekteve te realizuara.

| **c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)** | **d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht etj.)** |
|---|---|
| • Drejtoria e Bujqësisë e Bashkisë Shijak<br>• Drejtoria e Kullimit dhe Ujitjes | Bashkia e Shijak |

**e) Shpenzimet e llogaritura ( për cdo aktivitet të mësipërm (pika III)**

| **Shpenzimet për cdo aktivitet** | | Totali (000 lek) | Nga kjo: | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga, sig | operative | kapi |
| A.1 | Ngritja e grupit të punës në Bashki . Mbledhja, përpunimi, kartelizimi dhe njësimi i informacionit të studimeve te kryera; | 500 | | 500 | |
| A.2 | Vlerësimi i situatës dhe përcaktimi i prioriteteve | | x | | |
| A.3 | Përpilimi i dokumentacionit të nevojshëm për hapjen e procedurave të tenderimit/ prokurimit dhe supervizimit | 100 | | 100 | |
| A.4 | Lidhja e kontratës me firmën fituese | | | | |
| A5 | Fillimi i punës dhe dorëzimi i veprës. | 3000 | | | 3000 |
| **Shuma** | | **3600** | x | 100 | 3000 |

| **f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon)** **Janar – Dhjetor 2017** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** **Drejtoria e Bujqësisë** |
|---|---|